



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0566

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-kryetarë, Vedat Poterqoi-anëtarë dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatoreve Ekonomik (OE) “Mendi-P”SH.P.K.&”NPN Euroing”SH.P.K.&”Fer-Petrol”SH.P.K.&”N.N.SH. World Medium”, kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të Komuna Glllogoc në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi dhe Xheve Lladrovci, Drenas” me numër të prokurimit: 611-23-2223-5-1-1, me 04/12/2023, mori:

Vendim

1. Hedhet e palejuar ankesa e GOE “Mendi-P”SH.P.K. & ”NPN Euroing”SH.P.K.&”Fer-Petrol”SH.P.K.&”N.N.SH. World Medium” e parashtruar me 11.08.2023 (me numër protokolli 566/23) dhe Mbetet në fuqi vendimi i Komunës së Glllogocit nga cilësia e autoritet kontraktues për aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Drenas” me numër të prokurimit: "611-23-2223-5-1-1".
2. Lejohetkthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që ankuesi ka të drejt që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me nenit 31 paragrafit 6 të Rregullores së Punës në OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.
3. Të iniciohet procedura për marrje të masës disiplinore ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit në Komunën e Glllogoc për shkak të shkeljeve të evidentuara si më poshtë në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.06.2023, Komuna Glllogoc në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi dhe Xheve Lladrovci, Drenas” me numër të prokurimit: 611-23-2223-5-1-1.

Ndërsa me datën 26.07.2023 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë Grupin e Operatoreve Ekonomik ILEAA-GR SH.P.K.: DELTA –CCD SH.P.K.: Froni 1 SH.P.K..

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 4.342.660.60 €.

Me 31.07.2023, OE “MendiP” SH.P.K. & “NPNEuroing” SH.P.K. & “FerPetrol” SH.P.K. & “N.N.SH. World Medium” ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 25.08.2023, Autoriteti kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.08.2023, OSHP ka pranuar ankesë nga Grupin e Operatoreve Ekonomik, “Mendi-P” SH.P.K. & “NPN Euroing” SH.P.K. & “Fer-Petrol” SH.P.K. & “N.N.SH. World Medium”, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi dhe Xheve Lladrovci, Drenas” me nr. të prokurimit: “611-23-2223-5-1-1”.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Pretendimet e grupit të operatoreve ekonomik ankues, janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Pretendimi ankimor i Grupit të OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, Kërkesa 3. Vlerësimi i riskut për kompani nga një kompani e licencuar nga organi kompetent (MPMS).

Pretendimi i dytë (II). Pretendimi ankimor i Grupit të OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. *Pretendimi i tretë (III).* Pretendimi ankimor i Grupit të OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat mbi aspektin punëve të kryera, listën e kontratave të realizuarane tri vitet e fundit. *Pretendimi i katërt (IV).* Pretendimi ankimor i Grupit të OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ ose profesionale në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë,

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14/08/2023 ka autorizuar Ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 566/23, ndërsa me datë 24/08/2023 është dorëzuar raporti me rekomandim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura si dhe tërheqjen e dy anëtareve të Grupit të OE, i rekomandohet Panelit shqyrtues, që ankesa e Grupit të OE “MENDI-P SH.P.K.; NPN EUROING SH.P.K.; FER-PETROL; N.N.SH. WORRLD MEDIUM ”, të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e GOE “Mendi-P”SH.P.K.&”NPN Euroing”SH.P.K.&”Fer-Petrol”SH.P.K.&”N.N.SH. World Medium”, eksperti shqyrtues dhe teknik përmes raportit nr. 2023/0566 ka vlerësuar pretendimet ankimore të palës ankuese.

Pretendimi i parë (I) ankimor. Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i Operatoreve Ekonomik ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij ky Grup i OE kanë dorëzuar vlerësimin e riskut mirëpo vlerësimi i riskut nuk është i noterizuar si dhe kompania që ka bërë vlerësimin e riskut ju mungon licenca pasi që si dëshmi është kërkuar vetëm për liderin e grupit.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë dhe dëshmi të dorëzuara nga Grupi i OE, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimor i grupit të OE është i pa bazuar.

Pretendimi i dytë (II) ankimor. Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij, ky Grup i OE dhe lideri i saj kanë dorëzuar dëshmi nga banka për mbështetje financiare në vlerë prej 1.000.000.00 Euro, ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. Duke ju referuar dëshmi të dorëzuara nga Grupi i operatoreve ekonomik, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimor i grupit të OE është i bazuar. Pretendimi i tretë (III) ankimor. Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij, ky Grup i OE, secili anëtar i grupit kanë dorëzuar listën e kontratave. Pasiqë në dosjen e tenderit është kërkuar që lideri i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të vlerës së kërkuar, min. 5.500.000.00E sipas listës së kontratave të dorëzuara nga lideri rezultojnë që vlera e kontratave të realizuara është 2.621.923.57 Euro. Në qoftë se llogaritet vlera e kërkuar $5.500.000.00 \text{ Euro} \times 60\% = 3.300.000.00 \text{ Euro}$ nga kjo shihet që udhëheqësi, lideri i grupit nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi që ka vetëm 2.621.923.57 Euro, kontrata të realizuara sipas listës së kontratave. Duke dëshmi të dorëzuara nga Grupi i OE, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimor i grupit të OE është i pa bazuar. Pretendimi i katërt (IV) ankimor. Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij ky Grup i OE kanë dorëzuar listën e stafit teknik (Punonjës). Pasi në dosjen e tenderit është kërkuar minimum 40 punonjës, 25 prej tyre të jenë të Certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të punëtorëve të kërkuar. Nga lista e punëtorëve të dorëzuar janë gjithsej 35 punëtor, nga ky numër 13 punëtor nuk kanë dëshmi kontrata të punës ndërsa 22 punonjës kanë kontrata pune. Ndërsa prej 35 punëtorëve që janë në listën e punëtorëve prej tyre 19 punëtor nuk kanë certifikatat e sigurisë në punë, ndërsa 16 punëtor i kanë certifikatat e sigurisë në punë.

Anëtari i grupit N.N.SH”World Medium(Burim Zabelaj B.I) është tërhequr nga grupi dhe ka hequr dore nga ankesa , emali i dërguar ne OSHP, me 11.8.2023, si me poshtë.

Po ashtu N.N.SH. “WORLD MEDIUM (BURIM ZABELAJ B.I.)” me datë 11/08/2023 permes emailit ju është drejtuar Organit Shqyrtues të Prokurimit duke njoftuar citoj “ Si kompani: N.N.SH.WORLD MEDIUM(Burim Zabelaj b.i) nuk jemi pjesë e asnjë Kërkese për Rishqyrtim apo ndonjë Ankese tjetër në ndonjë institucion tjetër përshkak se nuk duam që të jemi pengesë në procedura dhe implementim të këtij projekti kaq të rëndësishëm për Qytetin e Glogocit por edhe për qytetarët e këtij vendi.”

Gjithashtu ju informoj se i kam informuar antarët e tjerë të konzorciumit për shkresën time si dhe për vendimin tonë që mos të merremi me Ankese. Duke pasur parasysh që antarët e tjerë të konzorciumit si kanë marrë parasysh sugjerimet tona Ne ju njoftojmë që tërhiqem nga ky konzorcium dhe nuk jam pjesë e këtij konzorciumi.” Shih foton si më poshtë

Po ashtu me 23/8/2023 anëtari i dytë i grupit FER PETROL është tërhequr nga grupi dhe ka hequr dore nga ankesa, si me poshtë.

Me daten 23/08/2023 anetari i konzerciumit te Grupit të OE “MENDI-P SH.P.K.; NPN EUROING SH.P.K...; FER-PETROL; N.N.SH. WORRLD MEDIUM”, Operatori Ekonomik N.T. “FER PETROLL” permes emailit ka derguar Komunes se Glogoc – Zyra e Prokurimit shkrese me te cilin i njofton se terhiqet nga procedura ankimore e konzerciumit “MENDI-P SH.P.K.; NPN EUROING SH.P.K...; FER-PETROL; N.N.SH. WORRLD MEDIUM”, si ne vijim:



N.T FER PETROLL – Tërstenik-Drenas
NUI: 810247967
044/431/851

Date: 23.08.2023

NJOFTIM

Kompania N.T Fer Petroll ju njoftone se terhiqemi nga procedura ankimore e konzerciumit: MENDI-P SH.P.K&NPN EURO ING SHPK&FER PETROL&N.N.SH.WORLD MEDIUM me te cilin kemi marrur pjesë në tenderin e publikuar nga K.K DRENAS ne projektin me titull:

Zgjerimi dhe ndertimi i sheshit Fehmi dhe Xheve LLadrovci Drenas , me numër të prokurimit: 611-23-2223-S-1-1

N.T FER PETROLL



Duke ju referuar dëshmime të dorëzuara nga Grupi i OE, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimor i grupit të OE është i pa bazuar.

-Konstatimi i Panelit Shqyrtues-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa

parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, në kontekstin e veprimeve dhe akteve të ndërmarra nga palët, Paneli konsideron (natyrisht nga pikëpamja e tij/sajë) se çështja kontestuese në rastin konkret, kryesisht i referohet statusit të ankuesit, respektivisht faktit nëse ankuesi e ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me dispozitën e nenit 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP. Në të vërtetë, statusi i palës, paraqet çështje substanciale në këtë proces ankimor, përderisa është kusht (prezumim) i domosdoshëm, i karakterit procedural nga i cila varet e drejta e pjesëmarrjes ose jo në një çështje juridiko administrative, duke e nënkuptuar prokurimin publik si të tillë, në vështirësi të parimeve bazë të legjislacionit. Vështiruar nga ky aspekt mund të konstatohet se ankuesit i mungon statusi i palës përderisa statusi i palës në rastin konkret i referohet konzorciumit (në përbërjen complete të tij) i cili gjatë rrjedhjes së aktivitetit të prokurimit në fakt është shpërbërë.

Lidhur me këtë duhet kujtuar se në kuptim të nenit 71 grupi i operatorëve ekonomik anëtarët e grupit (nënkupto të konzorciumit) kanë të drejtë të dorëzojnë ftesë për pjesëmarrje ose një tender duke e konfirmuar këtë fakt (sipas paragrafi 2, të këtij neni) përmes deklaratës së tyre të përbashkët sipas së cilës nënkuptohet se vetëm si të tillë janë paraqitur si palë. Në të vërtetë, gjatë administrimit të shkresave të kësaj lënde paneli vërejtë se lidhur me këtë aktivitet kanë ofertuar Grupi i Operatoreve Ekonomik “MendiP” SH.P.K.&” NPN Euroing” SH.P.K.&”FerPetrol” SH.P.K.&”N.N.SH. World Medium”. Megjithatë është jo kontestuese se gjatë rrjedhjes së këtij aktiviteti me 11.08.2023 se është tërhequr njëri nga anëtarët e konzorciumit N.N.SH ”World Medium (Burim Zabelaj B.I) kurse ndërkohë, respektivisht me 3.08.2023 është tërhequr nga konzorciumi po ashtu edhe anëtari i dytë i grupit FER PETROL. Nga ana tjetër, paneli shqyrtues vëren se AK ka nënshkruar kontratën gjatë periudhës së pezullimit e cila është në kundërshtim me nenin 112 të LPP, sipas të cilit "...dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin kontraktues që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë".

Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli konsideron në këtë çështje ankimore nuk mund të lëshohet në vlerësimin e pretendimeve lidhur me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për faktin se ky vendim ka apriori karakter procedural, megjithatë përgjegjësia ligjore mbi vlerësimin dhe rekomandimin e operatorit ekonomik për dhënie të kontratës gjatë një faze të tillë i adresohet AK pasi që ka bërë vlerësimin e përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës gjatë kohës sa kanë qenë në fuqi efektet juridike të pezullimi në kuptim të nenit 112 të LPP. Në raport me këtë, duhet theksuar se sipas nenit 59 paragrafi 1, të LPP thuhet se “Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi linjën në fuqi të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit në rastin konkret duke u nisur kryesisht nga parimi i përgjithshëm i interesit publik duke ju referuar nenit 104 par. 4 pika (iii) të LPP-së, sipas të cilit OSHP duhet të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave duke përfshirë interesin publik. Mirëpo duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104 paragrafi 1 dhe 4, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, Paneli konsideron se megjithatë AK nuk ka vepruar në harmoni me kërkesat e nenit 112 (efekti pezullues i ankesave) dhe se në këtë rast gjen zbatimin aplikimi i masave ndëshkimore ndaj AK në kuptim të nenit 105, paragrafët (2.1; 2.2; 2.15) të LPP sipas të cilit OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi të shqyrtojnë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji dhe të hetojnë dhe të përcaktojnë faktet që kanë shkaktuar ankesat e tilla, lidhur me nenin 25, paragrafi 9, të LPP sipas të cilit “në bazë të një kërkesë nga një autoritet kontraktues ose OSHP, KRPP-ja vendos nëse janë plotësuar kushtet e kualifikimit të specifikuar në nenin 23 apo janë bërë shkelje të rënda të këtij ligji ose rregullave të prokurimit për një certifikatë profesionale të prokurimit”. Neni 23 krijon efekt detyrues andaj nënshkrimi i një kontrate përkundër afatit dhe/ose efektit pezullues me rastin e ushtrimit të një ankese, përbën së paku mungesë të etikës profesionale.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA GLLOGOC**
- **OE - Mendi -P SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: